



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 42-17/2018 regjistër (JR)
Datë 11.04.2023

Nr. 20 i vendimit
Datë 10.05.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 10.05.2024, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 42-17/2018 (JR), datë 11.04.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino, e cila bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për

subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, dhe shkarkimin e saj nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, si dhe avokaten e saj, znj. Romina Zano, të cilat kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016¹ “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte kandidate për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Komisioni, në përfundim të këtij procesi, me vendimin nr. 42, datë 18.07.2018, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, me funksion prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë [...]”.
2. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, Komisioneri Publik Darjel Sina ushtroi ankim më datë 29.08.2018, me anë të të cilit, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoj përfundimisht nga Kolegji ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, dhe shkarkimin e saj nga detyra.
3. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Kolegji, me vendimin (JR) nr. 6, datë 28.02.2019, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 3 dhe 5, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.
4. Kundër vendimit të Kolegjit, znj. Antoneta Sevdari, bazuar në parashikimin e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, ushtroi ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”). Me vendimin nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, i cili mori formë të prerë më datë 13.03.2023, GjEDNj-ja vendosi:
 - E deklaron, unanimisht, të pranueshme ankesën për shkarkimin e kërkuar në mbështetje të nenit 8 të Konventës.
 - E deklaron, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme.
 - Gjykon, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për sa i përket shkarkimit të kërkuar. [...]

¹ Neni 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon: “4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit bën rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë [...]”.

5. Në datën 11.04.2023, znj. Antoneta Sevdari depozitoi në Kolegj një kërkesë, me objekt “Rishikim i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6, datë 28.02.2019”, duke e bazuar atë në parashikimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në parashikimet e nenit 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar”), me pretendimin se ekziston mundësia ligjore për rihapjen e procedurave, për shkak se: (i) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur shkelje të Konventës Evropiane dhe, për këtë arsye, në përputhje me germën “ë” të pikës 1 të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kjo gjetje përbën shkak për rishikimin e vendimit; (ii) gjykata ndërkombëtare ka dhënë dëmshpërblim, por e ka shoqëruar edhe me të drejtën e ankueses për rihapje të procesit; (iii) cenimi nuk është mënjeluar nga një rregullim i ri ligjor ose forma të tjera.
6. Kërkuesja, znj. Antoneta Sevdari, kërkoi nga Kolegji të marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim të vendimit të dhënë nga Kolegji lidhur me rivlerësimin e saj kalimtar, bazuar në nenin 8 të KEDNj-së dhe në nenin 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar dhe, në përfundim të shqyrtimit, të vendosë:
- *Pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019.*
 - *Prishjen e vendimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
- Ose:
- *Rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

II. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019

7. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën e sipërcituar, vlerësoi si vijon sa i takon:
- a) *Juridiksionit të Kolegjit*

7.1. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kësaj kërkesë, për sa kohë ka për objekt rishikimin e një vendimi të Kolegjit, i cili ka vendosur përfundimisht mbi procesin e rivlerësimit për ish-subjektin, znj. Antoneta Sevdari, mbi bazën e ankimit të ushtruar në Kolegj nga Komisioneri Publik, vendim i cili ka marrë formë të prerë, bazuar në parashikimin e nenit 497,

pika 1 e Kodit të Procedurës Civile², bën pjesë në kompetencën lëndore të Kolegjit, si gjykata më e lartë që ka shqyrtuar në themel çështjen për të cilën është marrë vendimi që kërkohet të rishikohet.

b) *Legjitimitit të kërkueses, znj. Antoneta Sevdari*

7.2. Kërkuessa, znj. Antoneta Sevdari, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, lexuar ky në harmoni me nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, me nenin 4, pika 6 dhe 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile³, dhe *ratione temporis* pasi kërkesa për rishikim është depozituar pranë Kolegjit brenda afatit ligjor prej 30 ditësh⁴ nga data e marrjes dijeni të shkakut të rishikimit, në përputhje me parashikimet e nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile.

c) *Respektimit të elementeve formale të kërkesës për rishikim të vendimit të formës së prerë*

7.3. Kërkesa është shkruar dhe është nënshkruar nga kërkuessa dhe avokatja e pajisur me prokurë, në përputhje me parashikimet e nenit 497, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile. Kërkesa është shoqëruar me dokumentacionin që provon: (i) shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, rasti i përcaktuar shprehimisht në nenin 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile: *kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë*; si dhe (ii) ditën e marrjes dijeni të këtij shkakut, në përputhje me kërkesat e nenit 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, referuar këtu komunikimit zyrtar të datës 15.03.2023, nga Regjistruesi i Seksionit nr. 3 në GjEDNj drejtuar z. S. P., me kredenciale {***}, në të cilin citohet se: *Vendimi i GjEDNj-së i datës 13 dhjetor 2022, në lidhje me aplikimin nr. 40662/19 “Sevdari kundër Shqipërisë”, është bërë përfundimtar më datë 13 mars 2023. Vendimi i sipërcituar rezultoi të jetë botuar në Fletoren Zyrtare më datë 14 prill 2023.*

² Neni 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494 të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës ose marrjes së dokumenteve”.

³ Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2/2008, në interpretim të “palës së interesuar”, referuar përcaktimit në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, ka arsyetuar: “Sipas nenit 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, e drejta për të paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, i përket në mënyrë të pavarur çdo personi që ka qenë palë në gjykimin e çështjes, për të cilën është dhënë vendimi dhe që ka interes të ligjshëm për rishikimin e tij”.

⁴ Siç rezulton nga aktet bashkëlidhur kërkesës për rishikim, vendimi i GjEDNj-së nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, ka marrë formë të prerë më datë 13 mars 2023 (në mesnatë), në përputhje me përcaktimet e nenit 44, paragraf. 2 i KEDNj-së, ndërsa kërkesa për rishikim të vendimit të Kolegjit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019, është depozituar në Kolegj nga ish-subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, më datë 11.04.2023, protokolluar në të njëjtën datë me nr. 489, që rezulton të jetë dita e 29-të e afatit ligjor për të paraqitur kërkesë për rishikim në përputhje me nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile.

ç) *Lidhur me shqyrtimin e kërkesës për rishikim*

7.4. Trupi gjykues çmoi se kjo kërkesë nuk është në kushtet e mospranueshmërisë së saj sipas përcaktimeve të nenit 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile dhe, për rrjedhojë, me vendim të ndërmjetëm, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për t'i dhënë mundësi Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe kërkuases, znj. Antoneta Sevdari, të dëgjohen dhe të mbajnë qëndrimin e tyre lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019.

7.5. Trupi gjykues, pasi e shqyrtoi kërkesën e znj. Antoneta Sevdari për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019, në seancë gjyqësore publike me praninë e kërkuases dhe të Komisioneres Publike, znj. Irena Nino, e cila përfundimisht u shpreh se kërkesa objekt shqyrtimi është në kushtet e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe Kolegji duhet ta pranojë atë, si dhe pasi konstatoi se provohet ekzistenca e rastit të përcaktuar në nenin 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për të cilin mund të kërkohej rishikimi i një vendimi që ka marrë formë të prerë, me vendim të ndërmjetëm, me shumicë votash, bazuar në nenet 494, shkronja “ë” dhe 498, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, vendosi: (i) *Pranimin e kërkesës së kërkuases, znj. Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019.* (ii) *Prishjen e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) nr. 6, datë 28.02.2019, dhe rigjykimin e çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit (JR) nr. 17, datë 13.09.2018, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018.* (iii) *Vazhdimin e gjyqimit të çështjes në themel në seancë gjyqësore publike në praninë e palëve.*

III. *Lidhur me rigjykimin në themel të çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit (JR) nr. 17, datë 13.09.2018, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018*

A. Pretendimet dhe shpjegimet e Komisioneres Publike, znj. Irena Nino

8. Komisionerja Publike Irena Nino parashtroi në Kolegj se në raport me rigjykimin e kësaj çështjeje dhe vazhdimin e gjyqimit të saj në themel, shkaqet konkrete të paraqitura në ankimin e Komisionerit Publik të datës 29.08.2018, kundër vendimit të Komisionit nr. 42/2018, janë bazuar në gjendjen në të cilën ndodhen aktet në dosjen e hetimit administrativ dhe mbeten të tilla edhe pas administrimit të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr. 40662/19, datë 13.01.2022. Sipas saj, në vendimin e GjEDNj-së lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kriterit të aftësive profesionale në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik dhe problematikave të parashtruara prej tij, të vlerësuara nga Kolegji dhe të arsyetuara në vendimin objekt rishikimi, nuk konstatohet ndonjë element i rëndësishëm që përbën shkak për rishikim analitik të ndryshëm të këtyre shkaqeve të ankimit, të parë në raport me ndonjë rrethanë të re të zbuluar rishtazi, duke bërë dallimin ndërmjet fakteve të ndodhura para marrjes së vendimit përfundimtar dhe fakteve të ndodhura pas marrjes së tij.

9. Duke pohuar që në rastin objekt gjykimi, rrethana e re e krijuar *a posteriori* është vendimi i GjEDNj-së, i cili ka konstatuar shkelje të së drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj private sipas nenit 8 të Konventës, si pasojë e vendimit të dhënë nga Kolegji për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisionerja Publike Irena Nino theksoi se është Kolegji ai, i cili, në rastin e ankimeve të Komisionerit Publik, në zbatim të parashikimeve të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, shqyrton çështjen dhe vendos standardet në bazë të parimeve kushtetuese, duke konkluduar në vendimmarrje sipas nenit 66 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të sa më sipër, Komisionerja Publike u shpreh se, në një rivlerësim prej saj të akteve në dosjen e Komisionit, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, çmon se në çështjen e rivlerësimit kalimtar të kërkueses, znj. Antoneta Sevdari, mbetet e paprovuar e kundërta e barrës së provës për sa vijon.
10. Komisionerja Publike Irena Nino parashtroi se *lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar një pjesë të pasurive të saj, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke e bazuar këtë konkluzion në pretendimet e mëposhtme.

10.1. Lidhur me pasuritë: (1) tokë arë me sipërfaqe 350 m²; dhe (2) shtëpi banimi (4 kate), ndodhur në {***}, Tiranë, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së shumës prej 3.000.000 lekësh (përfshirë shumën prej 12.000 eurosh, të siguruar nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite), të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim i krijimit të këtyre dy pasurive, për pjesën takuese prej 1/3 e truallit + ndërtesë, Komisionerja Publike pretendoi se: (i) sa u takon të ardhurave nga emigracioni i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Greqi, të deklaruara si burim për krijimin e pasurive të sipërcituara, nuk provohet se përmbushet standardi i të ardhurave të ligjshme sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar niveli i këtyre të ardhurave, fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, si dhe dërgesa e tyre nga vendi i origjinës në Shqipëri në periudhën e deklaruar; (ii) sa u takon të ardhurave në vlerën prej 12.000 eurosh, të deklaruara si të realizuara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2003, nga puna në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Komisionerja Publike pretendoi se, referuar akteve në dosje, këto të ardhura janë deklaruar dhe pretenduar gjatë hetimit administrativ, pasi subjekti nuk i kishte deklaruar ato në deklaratën vjetore të vitit 2003. Sipas Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2003, kishte deklaruar vetëm pagën e personit të lidhur (bashkëshortit) nga shoqëria “{***}” ShPK, nuk kishte një kontratë pune ku të identifikoheshin marrëdhëniet me punëdhënësin dhe pagesa e pretenduar, nuk gjendej asnjë e dhënë mbi mënyrën se si ishte kryer kjo pagesë dhe nëse për këto të ardhura ishin paguar detyrimet tatimore, për t’i konsideruar ato si atë ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në vlerësim të Komisioneres Publike, për periudhën 2000-2003, në të cilën subjekti deklaroi se kishte shpenzuar rreth 3.000.000 lekë për krijimin e pjesës takuese prej 1/3 të pasurive objekt kontrolli, dhe 3.000 deri në 4.000 euro për mobilim, të ardhurat e

ligjshme nuk i mbulonin këto shpenzime të deklaruara, duke qenë se ato rezultojnë vetëm në shumën 1.869.447 lekë. Për rrjedhojë, Komisionerja Publike pretendoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, nuk arriti të provonte të kundërtën e shkakut të ankimit lidhur me krijimin e këtyre dy pasurive, duke u ndodhur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

10.2. *Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së shumës prej 19.975,23 USD, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si të ardhur nga puna e bashkëshortit në Arabinë Saudite,* Komisionerja Publike Irena Nino u shpreh se edhe në këtë rast, të ardhurat e deklaruara nga kërkuesja nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke qenë se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, nuk u provua që për këto të ardhura të jenë paguar detyrimet përkatëse tatimore. Sipas Komisioneres Publike, vetëm fakti që në llogarinë në USD të subjektit të rivlerësimit ka kaluar në total shuma prej 19.975,23 USD, nëpërmjet 2 transfertave bankare në datat 28.04.2006 dhe 13.07.2006, me të njëjtin përshkrim: “Receipt of International Inc. MT”⁵, me urdhërues “{***}”, dhe e pretenduar si të ardhur nga puna e bashkëshortit, si inxhinier topograf, pranë shoqërisë “{***}”, në Arabinë Saudite, nuk është i mjaftueshëm për të legalizuar këtë vlerë si të ardhur të ligjshme.

11. *Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale,* Komisionerja Publike parashtroi se humbja e afatit të ankimit kundër vendimit nr. {***}, datë 21.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për “Pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit G.D.”, si dhe pohimi nga ana e subjektit të rivlerësimit se, deri në momentin e mospranimit nga gjykata të kërkesës për rivendosje në afat, nuk e njihte mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të *rastit fator*, provon se për rastin në fjalë, kërkuesja ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe të atyre organizative. Komisionerja Publike arsyetoi se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka reflektuar njohuri dhe gjykim të dobët, duke afektuar indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, për këtë arsye, duhet vlerësuar së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
12. *Lidhur me denoncimin e shtetasit D. B. ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, të depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 26.02.2024, si dhe të përcjellë njëkohësisht Kolegjit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit,* Komisionerja Publike Irena Nino parashtroi se ndonëse materiali që i përkiste këtij denoncimi⁶ dukej se i përmbante elementet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, ajo i konsideroi të mjaftueshme aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit për

⁵ Komisionerja Publike referon: “Referojuni përgjigjes së ProCredit Bank, dërguar Komisionit, me shkresat nr. {***} prot., datë 8.2.2018; nr. {***} prot., datë 28.2.2018; nr. {***} prot., datë 7.3.2018”.

⁶ Sipas Komisioneres Publike, materiali i këtij denoncimi, ndër të tjera, i referohet çështjes së arbitrazhit nr. ARB/15/28, Hydro s.r.l and Others kundër Republikës së Shqipërisë, trajtuar nga Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve, krijuar nga Konventa për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve midis Shteteve dhe Shtetasve të Tjera (Konventa ICSID).

të konkluduar dhe mbajtur një qëndrim përfundimtar mbi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 6/2019 (JR) dhe, rrjedhimisht, duke e lënë në konsideratë dhe vlerësim të Kolegjit çmuarjen e fakteve dhe rrethanave të këtij denoncimi, në përputhje me parashikimet e nenit 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

13. Komisionerja Publike theksoi se ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur vetëm në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit. Për rrjedhojë, bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisionerja Publike kërkoi nga Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e sipërcituara dhe, në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.*

B. Pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari

14. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi qëndrimin e Komisioneres Publike në tërësi dhe pretendoi se Komisionerja Publike nuk mund të riparaqesë të njëjtën parashtrësë dhe kërkim për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit, pa argumentuar më parë se shkarkimi i subjektit, ndryshe nga sa ka argumentuar GjEDNj-ja, përbën një sanksion proporcional të aplikuar mbi faktet e provuara dhe të pranuar, që nuk vihen më në diskutim. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisionerja Publike Irena Nino ka paraqitur si shkaqe ankimore të njëjtat fakte që kanë çuar në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj ankuseses sipas vendimit të Kolegjit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, por nuk i ka rivlerësuar këto fakte në dritën e shkakut të rishikimit – vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*.
15. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë mjetet e ankimit, mjet i jashtëzakonshëm i të cilit është edhe rishikimi, nenit 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁷, kuptohet se qëllimi dhe lënda e rishikimit të çështjes objekt gjykimi lidhet me konkluzionin e GjEDNj-së, i cili është shkak i kërkesës për rishikim të vendimit të Kolegjit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, me synimin e marrjes së një vendimi në përputhje me të drejtat që janë konstatuar të jenë cenuar.
16. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se në analizë të legjislacionit vendas dhe jurisprudencës së gjykatave shqiptare, konkluzionet e arritura nga GjEDNj-ja nuk mund të vihen në diskutim nga

⁷Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 25/2011 dhe nr. 74/2016.

gjykatat apo institucionet e brendshme, për shkak se vendimet e GjEDNj-së kanë supremaci në sistemin e burimeve normative dhe janë të zbatueshme drejtpërsëdrejti.

17. Në këto kushte, sipas subjektit të rivlerësimit, objekti dhe lënda e shqyrtimit në këtë gjykim është vlerësimi i proporcionalitetit të masës së shkarkimit, mbi vlerësimin e Kolegjit për shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik të datës 29.08.2018, të rikonfirmuara edhe nga Komisionerja Publike Irena Nino në këtë gjykim, të cilat lidhen me: (i) ligjshmërinë e të ardhurave në shumën prej 3.000.000 lekësh, një pjesë e së cilës është krijuar nga emigracioni i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Greqi, gjatë viteve 1997-2000, kurse pjesa tjetër në vlerën prej 12.000 eurosh, nga puna e bashkëshortit në Mbretërinë e Arabisë Saudite në periudhën qershor - nëntor 2003, të ardhura këto që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë truall + ndërtesë (1/3-tës pjesë takuese), në {***}, Tiranë; (ii) ligjshmërinë e të ardhurave në shumën e 19.975,23 dollarëve amerikanë, me burim krijimi punën e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006; si dhe me (iii) vlerësimin në kuadër të kriterit të vlerësimit profesional sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të një dosjeje penale të referuar në vendimin e Kolegjit objekt rishikimi si *Rasti 5*, në të cilën rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte humbur afatin ligjor për ushtrimin e ankimit kundër vendimit nr. {***}, datë 21.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të të cilit kjo gjykatë kishte vendosur pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit G. D., i akuzuar për veprën penale “Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar në nenin 257/a/1 të Kodit Penal.
18. Subjekti i rivlerësimit, pasi parashtroi vendimmarrjen e Kolegjit objekt rishikimi lidhur me shkaqet e sipërcituara të ankimit të Komisionerit Publik, si dhe arsyetimin përkatës të GjEDNj-së lidhur me vlerësimin e kryer nga Kolegji mbi këto shkaqe ankimi, në kuadër të shqyrtimit prej GjEDNj-së së kërkesës të subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për jetë private të parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, si pasojë e vendimit të Kolegjit nr. 6/2019 (JR) për shkarkimin e saj nga detyra, ritheksoi se konkluzionet e arritura nga GjEDNj-ja në çështjen objekt gjykimi, sipas të cilave masa disiplinore e shkarkimit ishte vlerësuar joproporcionale në raport me qëllimet legjitime të procesit të rivlerësimit, nuk mund të jenë objekt rivlerësimi, rishqyrtimi, por sipas saj janë drejtpërsëdrejti të detyrueshme dhe të zbatueshme. Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u shpreh se, për këtë arsye, Komisionerit Publik i kanë rënë shkaqet ankimore, sepse ato nuk mund të çojnë në marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj saj dhe, në këtë kuptim, kërkimi përfundimtar i Komisioneres Publike për të aplikuar masën e shkarkimit mbi të njëjtat shkaqe ankimore është në shkelje flagrante të nenit 8 të KEDNj-së.
19. Në përfundim, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, dhe avokates së saj, zbatimi i nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e fakteve të konstatuara apo të të njëjtave shkaqe ankimore të Komisionerit Publik, të vlerësuar tashmë nga GjEDNj-ja, është i gabuar dhe në kundërshtim me parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, bazuar në nenet 8 dhe 46 të KEDNj-së, vendimit të GjEDNj-së nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për çështjen “Sevdari

kundër Shqipërisë”, si dhe nenit 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenit 494 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, kërkuar *lënien në fuqi të vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018 dhe konfirmimin në detyrë të kërkuases Antoneta Sevdari, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

C. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

20. Kolegji, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në kuadër të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik të ushtruar më datë 29.08.2018, kundër vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, ka vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të znj. Antoneta Sevdari, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në konkluzionet se:

20.1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruar, pasi kishte bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar një pjesë të pasurive të saj, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke iu referuar këtu fakteve se:

- (i) Lidhur me të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën prej 3.000.000 lekësh, krijuar pjesërisht nga emigracioni i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Greqi, gjatë viteve 1997-2000 dhe pjesërisht (në shumën prej 12.000 eurosh) nga puna e këtij të fundit në Mbretërinë e Arabisë Saudite për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën qershor - nëntor 2003, si burim për krijimin e 1/3 pjesë takuese të pasurive tokë arë dhe godinë banimi, me vendndodhje në {***}, Tiranë, nuk u arrit të provohet se këto të ardhura përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme, duke e vendosur për pasojë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë për të cilat këto të ardhura kishin shërbyer si burim krijimi, në kuptim të parashikimeve të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
- (ii) Lidhur me të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në shumën 20.000 USD, nga shërbimet e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006, nuk u arrit të provohet se për këto të ardhura ishin përmbushur detyrimet tatimore përkatëse, duke u vlerësuar nga Kolegji se edhe në këtë rast, nuk ishin përmbushur kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu, Kolegji çmoi të mbante në konsideratë në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit kalimtar të subjektit, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një sjellje që cenonte besueshmërinë e subjektit për të kërkuar përpikëri në respektimin e ligjit, rrjedhimisht edhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, faktin që kjo e ardhur, në

momentin e krijimit të saj në vitin 2006, ishte depozituar në një llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ndërkohë që ajo ushtronte funksionin e prokurores dhe ishte përgjegjëse për ndjekjen e veprave penale në lidhje me taksat dhe tatimet, duke bërë të papranueshëm, në vlerësimin e Kolegjit, mosprovimin prej saj të pagimit të tatimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, lidhur me këto të ardhura të deklaruara të bashkëshortit.

20.2. *Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, nga Kolegji u arrit në konkluzionin se humbja e afatit të ankimit dhe pohimi nga ana e subjektit të rivlerësimit se, deri në momentin e mospranimin nga gjykata të kërkesës për rivendosje në afat, nuk e njihte mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të *rastit fator*, ndonëse provonte shfaqje të mungesës së aftësive profesionale dhe atyre organizative në trajtimin nga subjekti i rivlerësimit të kësaj dosjeje penale, në konsideratë të faktit që mangësia e konstatuar në njohjen e doktrinës dhe jurisprudencës së krijuar lidhur me konceptin juridik të *rastit fator*, si dhe mungesa e efektivitetit në menaxhimin e situatave komplekse gjatë ushtrimit të detyrës, u konstatua të jenë situata të izoluara në kuadër të vlerësimit të tërësisë së burimeve mbi të cilat ishte kryer procesi i vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit nga Komisioni, u arrit në përfundimin se rezultati i këtij rasti nuk ishte i mjaftueshëm për t’u konsideruar mangësi profesionale, i cili, në mënyrë të pavarur, mund të sillte si pasojë marrjen e masës disiplinore, në kuptim të dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 84/2016, për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale. Në kushtet që kjo problematikë e evidentuar gjatë vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale tregoi për dështim të organit të prokurorisë për të çuar deri në fund ndjekjen penale ndaj zyrtarëve publikë, të cilët kanë probleme ligjore me deklarinimin dhe fshehjen e pasurisë, që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ky rast u çmua se ndikonte në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit të subjektit, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

20.3. Përfundimisht, *nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit*, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për situatat e evidentuara gjatë vlerësimit të këtyre dy kriterëve, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

- 21.** Në kuadër të ankimit të ushtruar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga subjekti i rivlerësimit ndaj vendimit të sipërcituar të Kolegjit, në zbatim të parashikimeve të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, kjo gjykatë – pasi shqyrtoi pretendimet e kërkuases, znj. Antoneta Sevdari: (i) për shkelje të së drejtës për respektim të jetës private, sipas nenit 8 të KEDNj-së, për shkak të shkarkimit të saj nga detyra me vendimin e Kolegjit nr. 6/2019 (JR) [...]; (ii) për proces të padrejtë në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së; dhe (iii) për mungesën e një mjeti efektiv në lidhje me ankesat e saj në mbështetje të neneve 6 dhe 8 të Konventës – konstatoi se kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuases për të respektuar jetën e saj private, sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e saj, sepse, në rrethanat specifike të çështjes së saj, shkarkimi nuk kishte qenë proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Në drejtim të masave individuale që do të ishin më të përshtatshme për t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar në çështjen konkrete, GjEDNj-ja konstatoi se, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete dhe për sa mund

të ishte e mundur sipas ligjit vendës, një formë e përshtatshme korrigjimi për shkeljen e së drejtës të kërkuar për respektim të jetës së saj private sipas nenit 8 të Konventës, do të ishte rihapja e procesit me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, si edhe rishqyrtimi i çështjes në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, ashtu siç përcaktohej në vendimin e kësaj gjykate⁸.

22. Nga shqyrtimi i vendimmarrjes së GjEDNj-së lidhur me çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, Kolegji vëren se në analizën e kryer në vlerësim të kriterit nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar, GjEDNj-ja, duke iu referuar jurisprudencës së saj në lidhje me kushtet që nevojiten që një masë të jetë “në përputhje me ligjin”, duke përfshirë veçanërisht, kërkesën e parashikueshmërisë, që do të thotë se ligji konkret duhet të parashikojë me saktësi të mjaftueshme kushtet sipas të cilave mund të zbatohet masa e dhënë, ka arsyetuar në vendim se shkarkimi i kërkuar ishte mbështetur në të njëjtat parashikime të ligjit të rivlerësimit, si ato të marra në analizë në vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, duke konstatuar se sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të organeve të rivlerësimit, neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duhet të lexohet në harmoni me nenin 33, pika 5 e të njëjtë ligj dhe me nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësim të GjEDNj-së, referuar këtyre parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, është e qartë se, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar, të ardhurat ose burimet e fitimeve të një individi do të konsiderohen të ligjshme vetëm nëse deklarohen në mënyrën e duhur, dhe nëse për to janë paguar tatimet. Në këto rrethana, GjEDNj-ja ka vlerësuar se parashikimet ligjore të cilat ishte mbështetur shkarkimi i kërkuar, znj. Antoneta Sevdari, përmbushnin kërkesën e parashikueshmërisë dhe, për këtë arsye, vendimi për ta shkarkuar atë ishte marrë “në përputhje me ligjin”.
23. GjEDNj-ja gjithashtu nuk gjeti asnjë arsye për të dyshuar se ndërhyrja në të drejtën e kërkuar për të respektuar jetën e saj private, duke e shkarkuar atë nga detyra, kishte objektivitet të ngjashëm dhe në këtë mënyrë ndiqte qëllimet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të të drejtave dhe lirive të të tjerëve, sipas kuptimit të nenit 8, paragrafi 2 i KEDNj-së, në të cilin përcaktohen shprehimisht rastet dhe kriteret kur përjashtimisht, ndërhyrja në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare nuk konsiderohet shkelje e kësaj të drejte konventore⁹. GjEDNj-ja ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, se masat e parashikuara nga legjislati që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, i cili ishte miratuar për të siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe rikthimin e besimit të publikut në këtë sistem, në përgjithësi u shërbenin interesave të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, sipas kuptimit të nenit 8, paragrafi 2, përfundim ky i arritur bazuar edhe në raportet vendase dhe ato ndërkombëtare

⁸ Për më tepër, shih paragrafët 143-145 të vendimit të GjEDNj-së për çështjen “*Sevdari kundër Shqipërisë*”.

⁹ Në nenin 8 të KEDNj-së, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*” përcaktohet shprehimisht: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

[veçanërisht atyre të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)], sipas së cilave arrihej në përfundimin që ekzistonte një nivel i lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

24. Në kuadër të vlerësimit nëse ndërhyrja ka qenë e “nevojshme në një shoqëri demokratike”, GjEDNj-ja ka ritheksuar se çdo ndërhyrje në të drejtën për të respektuar jetën private do të konsiderohej e nevojshme në një shoqëri demokratike nëse i përgjigjet “një nevojë sociale urgjente” dhe, veçanërisht, nëse ajo është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. Në kuadër të kësaj analize, kjo gjykatë thekson se reforma në sistemin e drejtësisë, e cila solli nevojën e rivlerësimit të jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, dhe potencialisht shkarkimin e tyre, erdhi si përgjigje ndaj një “nevojë sociale urgjente”. GjEDNj-ja vlerëson se për sa ka të bëjë me proporcionalitetin midis shkarkimit të kërkueses dhe qëllimeve legjitime të ndjekura, shkarkimi nga detyra – kryesisht i gjyqtarëve ose i prokurorëve me status jetëgjatë në sistem – është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që mund të merret ndaj një individi. Thënë kjo, referuar GjEDNj-së, vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit objekt rivlerësimi kalimtar. Në kuptim të sa më sipër, në analizë të çështjes konkrete, GjEDNj-ja ka konstatuar se shkarkimi i kërkueses (subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari) mbështetej në vlerësimin e pasurive të saj dhe në vlerësimin e kompetencës së saj profesionale.

25. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, GjEDNj-ja vëren se: *të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, të konstatuara nga KPA-ja, kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj.*

25.1. Në këtë kontekst, sipas GjEDNj-së, *për sa u përket parregullsive në lidhje me shumën prej 3.000.000 lekësh, të fituar nga bashkëshorti i ardhshëm i subjektit të rivlerësimit si emigrant në Greqi gjatë viteve 1997–2000, sipas gjykimit të KPA-së, kërkuesja nuk kishte paraqitur prova për punësimin e tij në Greqi në atë kohë, dhe as nuk kishte paraqitur shumën e saktë të të ardhurave të gjeneruara nga puna e tij. Në lidhje me këtë aspekt, GjEDNj-ja ka potencuar se Kolegji ka shqyrtuar të ardhurat që bashkëshorti i ardhshëm i kërkueses i kishte fituar pesëmbëdhjetë-njëzet vjet përpara deklarimit të saj në procesin e rivlerësimit, në një periudhë kur ai nuk ishte martuar ende me të, gjithashtu, sipas kësaj gjykate, i rëndësishëm ishte edhe fakti se kërkuesja nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike e një roli tjetër që t’u nënshtrohej ligjeve për deklarimin e pasurive.*

25.2. *Për sa u përket parregullsive në lidhje me shumën 12.000 euro, të fituar nga bashkëshorti i kërkueses në Arabinë Saudite në vitin 2003, lidhur me vlerësimin e Kolegjit se kishte indicie për punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite, por se kërkuesja nuk i kishte deklaruar këto të ardhura më herët në deklaratën e saj të rivlerësimit dhe as nuk kishte*

provuar se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet për këto të ardhura, GjEDNJ-ja shprehet se ka mbajtur në konsideratë faktin se kërkuesja nuk e kishte deklaruar këtë shumë në vitin 2004 në deklaratën e përvitshme të pasurisë, përpara se ta deklaronte në deklaratën e rivlerësimit. Në lidhje me këtë aspekt, ajo gjykon se ky mosdeklarim ka të bëjë me deklarimin e parë të pasurisë së kërkueses, e cila kishte nisur të praktikonte ligjin si prokurore vetëm në tetor 2003, gjithashtu, sipas GjEDNJ-së, nga shqyrtimi i materialeve të kësaj çështjeje, ishte konstatuar se nuk ekzistonte asgjë që të tregonte se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nuk vinin nga një aktivitet fitimprurës i ligjshëm.

25.3 Në lidhje me parregullsitë me paratë e fituara nga bashkëshorti i ankueses në Arabinë Saudite në vitin 2006 (20.000 USD), GjEDNJ-ja konstatoi se kërkuesja ofroi prova të besueshme se bashkëshorti i saj kishte qenë i punësuar në atë periudhë në Arabinë Saudite dhe deklaroi shumën e fituar në deklaratën e saj të përvitshme të pasurisë për vitin 2006 dhe në deklaratën e saj të rivlerësimit, por nuk ofroi prova të dokumentuara se ai i kishte paguar tatimet mbi të ardhurat në Shqipëri ose në Arabinë Saudite. Sipas GjEDNJ-së, në lidhje me këto të ardhura, nuk u konstatua asgjë që mund të tregonte se ato nuk vinin nga një aktivitet i ligjshëm fitimprurës.

26. Në përmbyllje të analizës së saj lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, GjEDNJ-ja theksoi se kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra, pasi ishte konstatuar se ajo nuk kishte mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme, burimet e krijimit të së cilës ishin ekskluzivisht të ardhurat e bashkëshortit të saj, të cilat përfshinin të ardhurat e fituara prej tij në kohën kur kërkuesja nuk ishte as e martuar me të dhe as prokurore. Ndërkohë që burimet e tjera nuk ishin konsideruar të ligjshme, kryesisht pasi kërkuesja nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj kishte paguar taksat për të ardhurat e tij nga një punësim i ligjshëm jashtë vendit. GjEDNJ-ja, pasi ka vënë theksin se evazoni i mundshëm fiskal është një çështje serioze, për qëllimet e procedurave të rivlerësimit të kërkueses, arsyeton se me rëndësi për çështjen paraqitet fakti që shumat e të ardhurave të bashkëshortit, për të cilat nuk u provua nëse ishin paguar tatimet, përfaqësonin një përqindje relativisht të vogël të shumës në total të të ardhurave të bashkëshortit në periudhën konkrete, dhe se nuk ishte konstatuar asnjë parregullsi në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit nga burimet vendëse gjatë një sërë vitesh.
27. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, GjEDNJ-ja konstatoi se qasja e vetme që Kolegji kishte konstatuar në disfavor të saj, ishte fakti se ajo nuk kishte respektuar një afat për dorëzimin e apelimit në një çështje, rast të cilin vetë Kolegji e kishte konsideruar si një incident të izoluar në karrierën e subjektit të rivlerësimit, por duke qenë se çështja konkrete kishte të bënte me deklarimin e pasurive të një zyrtari publik, mosdorëzimi nga ana e saj e ankimit ndikonte në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, për qëllimet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. GjEDNJ-ja, pasi theksoi se nuk nënvlerëson në këtë këndvështrim rëndësinë e ndjekjes penale të veprave penale të pretenduara me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë, për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, gjykoi se, për sa më sipër, në këndvështrimin e Kolegjit, mosdorëzimi i ankimit nga ana e znj. Sevdari kishte qenë një incident i izoluar në karrierën e saj si prokurore, e cila kryesisht trajtonte rastet e krimeve

ekonomike dhe se nuk ishte argumentuar nëse çështja konkrete, e cila përfshinte një ish-zyrtar të qeverisë lokale, ishte e një profili veçanërisht të lartë.

28. Për sa më sipër, GjEDNj-ja gjykoi se, referuar një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave specifike të çështjes, shkarkimi i kërkueses (subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari), mbështetur kryesisht në faktin se ajo nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj i kishte paguar tatimet për një pjesë të të ardhurave të tij nga aktivitete të ligjshme gjatë dy dekadave të mëparshme, dhe në mungesë të ndonjë indicieje të keqbesimit apo të shkeljeve të qëllimshme nga vetë ajo, ishte joproporcional me qëllimet legjitime të procesit të rivlerësimit. Sipas këtyre rrethanave, referuar GjEDNj-së, me shkarkimin e kërkueses nga detyra, ishte shkelur neni 8 i KEDNj-së.
29. Ndërkohë, në lidhje me ankesën e znj. Antoneta Sevdari se procedurat e rivlerësimit që kishin rezultuar në shkarkimin e saj nga detyra e prokurores, kishin qenë të padrejta, duke pretenduar në këtë mënyrë shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, Kolegji vëren se, pasi vlerësoi të gjitha pretendimet e ankueses për cenim të së drejtës së saj për proces të rregullt ligjor, të ngritura përpara GjEDNj-së në formën e ankesave në lidhje me: (i) mungesën e pavarësinë dhe paanësisë së Kolegjit¹⁰; (ii) mangësitë e rënda procedurale në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, si pasojë e mosfrimit mjaftueshëm të mundësisë dhe kohës për ta paraqitur çështjen dhe provat e saj përpara Kolegjit¹¹; (iii) zbatimin nga Kolegji të ligjit vendas në një mënyrë dukshëm të gabuar¹²; si dhe të ankesës se (iv) barra e provës ndaj ankueses në procesin e rivlerësimit të saj në Kolegji, kishte qenë e paarsyeshme¹³, GjEDNj-ja kishte arritur në përfundimin për kundërshtimin si qartazi të pambështetura në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës, të ankesave të sipërcituara, duke e deklaruar përfundimisht të papranueshme atë pjesë të kërkesës që bazohej në pretendime në kuadër të nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, “E drejta për një proces të rregullt”.
30. Në kuadër të rigjyqimit në themel të çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit (JR) nr. 17, datë 13.09.2018, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, si pasojë e pranimit të kërkesës së znj. Sevdari për rishikimin e vendimit të Kolegjit për shkarkimin e saj nga detyra, për shkak të vendimit të GjEDNj-së se me këtë vendim ishte cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për respektimin e jetës private dhe familjare, parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, Kolegji thekson se procesi i rivlerësimit kalimtar, me natyrë *sui generis*, rregullohet sipas nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, dispozitat kushtetuese dhe ligjore të të cilave përcaktojnë se ky proces mund të përfundojë vetëm nëpërmjet dy alternativave vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit, konfirmimit në detyrë ose shkarkimit nga detyra të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi. Në këtë kuadër, masa disiplinore e pezullimit nga detyra, e shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit për një periudhë njëvjeçare, referuar parashikimeve të nenit 8 të Aneksit të

¹⁰ Shih arsyetimin e GjEDNj-së në paragrafët 114-119 të vendimit të saj për çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”.

¹¹ Shih “Sevdari kundër Shqipërisë”, par. 120-123.

¹² Shih “Sevdari kundër Shqipërisë”, par. 124-127.

¹³ Shih “Sevdari kundër Shqipërisë”, par. 128-132.

Kushtetutës, vlerësohet si një masë me karakter të përkohshëm dhe si një fazë transitore për arritjen e një vendimmarrjeje përfundimtare lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, konfirmimin në detyrë apo shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit të cilit i janë konstatuar mangësi të aftësive profesionale, të cilat mund të plotësohen.

31. Vendimmarrjet e Kolegjit, referuar parashikimeve të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, i nënshtrohen kontrollit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbi bazën e ankimit të subjekteve të rivlerësimit lidhur me pretendime mbi cenimin e të drejtave dhe lirive të tyre të mbrojtura sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë. Referuar nenit 46 të kësaj konvente, palët nënshkruese të saj, ndër to edhe Republika e Shqipërisë, kanë ndërmarrë detyrimin për të respektuar vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo çështje ku ato janë palë.
32. Kolegji vëren se GjEDNj-ja, me vendimmarrjet e saj në kuadër të ruajtjes dhe garantimit të të drejtave të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, gëzon një kompetencë ekskluzive në sistemin tonë të brendshëm juridik. Në sajë të kësaj kompetence të mirëpranuar nga sistemi i brendshëm i normave juridike, për efekt të zbatimit të parashikimeve të neneve 17, pika 2 dhe 122 të Kushtetutës, standardet e vendosura nga kjo gjykatë për respektimin e të drejtave themelore të njeriut, përbëjnë standardin minimal në gëzimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese, rrjedhimisht edhe vendimet e kësaj gjykate lidhur me sa më sipër, janë të detyrueshme dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë në interpretimin e standardeve kushtetuese për të drejtat e njeriut. Detyrimet e ndërmarra nga shteti shqiptar me ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjes kushtetuese të garantuar në sistemin e brendshëm juridik, nëpërmjet dhënies së përparësisë në zbatim ndaj çdo norme ligjore të brendshme që nuk pajtohet me të, kërkojnë respektimin dhe zbatimin e vendimmarrjeve të GjEDNj-së nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu edhe gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Në këtë kuptim, Kolegji arrin në përfundimin se standardet e vendosura nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, në kontekstin e garancive të ofruara për respektimin e së drejtës për jetë private dhe familjare të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, janë të detyrueshme dhe drejtpërsëdrejti të zbatueshme në çështjen objekt shqyrtimi para Kolegjit.
33. Në kuptim të sa më sipër, në analizë të përfundimeve të arritura nga GjEDNj-ja si më sipër trajtuar në këtë vendim, në konsideratë të faktit se në vendimin e saj në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, kjo gjykatë nuk ka konstatuar cenim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, lidhur me procedurat e kryera në Kolegji në funksion të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik të datës 29.08.2018, kundër vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, Kolegji vlerëson se, në rigjykimin e ankimit për shkaqet e rikonfirmuara pjesërisht nga Komisionerja Publike në seancën gjyqësore të datës 17.04.2024, analizimi i situatës faktike dhe asaj juridike mbi zbatimin e legjislacionit të brendshëm, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ishte i nevojshëm, për sa kohë vendimmarrja e Kolegjit objekt

kontrolli në GjEDNj, u cenua vetëm për shkak të konsiderimit joproporcionale të masës disiplinore të dhënë, “shkarkim nga detyra”.

34. Kolegji vlerëson se nga analizimi i situatës faktike të konstatuar gjatë gjykimit në themel lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, fakti që mangësia e konstatuar në njohjen e doktrinës dhe jurisprudencës së krijuar lidhur me konceptin juridik të *rastit fator*, si dhe mungesa e efektivitetit në menaxhimin e një situate komplekse gjatë ushtrimit të detyrës, u paraqitën si raste të izoluara në kuadër të vlerësimit të tërësisë së burimeve mbi të cilat ishte kryer procesi i vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit nga Komisioni, u vlerësuan të pamjaftueshme për të justifikuar arritjen në konkluzionin e dhënies së masës disiplinore të pezullimit nga detyra, të shoqëruar me detyrimin për trajnim për një periudhë 1-vjeçare, sipas parashikimeve të neneve E, pika 3 dhe Ë, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 60 të ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerësoi se vetë evidentimi i kësaj problematike dhe analizimi i thellë i saj gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit, lidhur me këtë situatë, kanë treguar se angazhimi i Shkollës së Magjistraturës në përgatitjen e një programi 1-vjeçar në korrigjimin e kësaj mangësie nuk ishte i nevojshëm dhe se vetë gjykimi i zhvilluar në Kolegj kishte shërbyer si një mundësi e përshtatshme për vetëkorrigjimin e kësaj problematike nga subjekti i rivlerësimit.
35. Bazuar në sa më sipër, përderisa nuk u konstatuan elemente të cilat do të justifikonin dhënien e një mase të përkohshme, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji arriti në konkluzionin se në kushtet kur parashikimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe vendimmarrja e GjEDNj-së lidhur me respektimin e saj, referuar parashikimeve kushtetuese, janë të detyrueshme për zbatim nga shteti shqiptar dhe, për sa kohë lidhur me çështjen objekt gjykimi, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra është çmuar nga GjEDNj-ja se ka cenuar nenin 8 të Konventës, e vetmja alternativë për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, e cila nuk do të binte ndesh me vendimin e GjEDNj-së lidhur me çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, duke përmbushur detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e këtij vendimi dhe korrigjimin e shkeljes së konstatuar nëpërmjet dhënies së një vendimi në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, do të ishte konfirmimi i subjektit të rivlerësimit në detyrë.
36. Në përfundim të rigjykimit në themel të çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit (JR) nr. 17, datë 13.09.2018, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, vlerëson se vendimi i Komisionit objekt gjykimi, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.05.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, nuk jam dakord me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, që i përket shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuësja Antoneta Sevdari, për *“Rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019”*, si në rastin e zbatimit të ligjit procedural, për sa i përket formës së gjykimit të kësaj kërkesë, ashtu dhe sa i përket juridiksionit kushtetues të Kolegjit, lidhur me shqyrtimin e kërkesave për rishikim.
2. Nga analiza e kryer në bazë të provave të administruara dhe fakteve të provuara, për efekt të këtij gjykimi, paraqitet kjo situatë faktike lidhur me shqyrtimin e kësaj kërkesë për rishikimin e vendimit të Kolegjit.

2.1. Kolegji, me vendimin nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 3 dhe 5, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, vendosi ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.

2.2. Bazuar në parashikimin e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, ish-subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari ushtroi ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”) kundër vendimit të mësipërm të Kolegjit. Me vendimin nr. 40662/19, datë 13.12.2022, për “Çështjen Sevdari kundër Shqipërisë”, i cili mori formë të prerë më datë 13.03.2023, GjEDNj-ja vendosi: (i) *e deklaron, unanimisht, të pranueshme ankesën për shkarkimin e kërkuësës në mbështetje të nenit 8 të Konventës*; (ii) *e deklaron, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme*; (iii) *Gjykon, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për sa i përket shkarkimit të kërkuësës [...]*.

2.3. Në datën 11.04.2023, ish-subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në cilësinë e kërkuësës, ka paraqitur në Kolegj kërkesën me objekt: *“Rishikim i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6, datë 28.02.2019”*, duke u bazuar, në parashikimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenit 71/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, me pretendimin se ekziston mundësia ligjore për rihapjen e procedurave, për shkak se: (i) GjEDNj ka gjetur shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe, për këtë arsye, në përputhje me germën “ë”, të pikës 1, të nenit 494, të Kodit të Procedurës Civile, kjo gjetje përbën shkak për rishikimin e vendimit; (ii) Gjykata Ndërkombëtare ka dhënë dëmshpërblim, por e ka shoqëruar edhe me të drejtën e ankueses për rihapje të procesit.

2.4. Kërkuësja Antoneta Sevdari kërkoi nga Kolegji marrjen në shqyrtim të kërkesës për rishikim të vendimit të dhënë prej tij, lidhur me rivlerësimin kalimtar të kryer, bazuar në nenin 8 të KEDNj-së dhe, në përfundim të shqyrtimit, të vendosë: *Pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019; Prishjen e vendimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; Rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të*

Apelimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

A. Lidhur me formën e gjykimit

3. Për sa i përket zbatimit të ligjit procedural, lidhur me formën e gjykimit, si gjyqtare në pakicë, kam vlerësuar se kjo kërkesë duhet të shqyrtohet në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, duke e analizuar pikësëpari në kuadër të juridiksionit kushtetues të Kolegjit. Një verifikim i tillë i kërkesës, nëse i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i dhomës së këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore publike.
4. Nuk jam dakord me konkluzionin e shumicës në pikën 7.4 dhe në pikën 7.5 të vendimit: [...] *Trupi gjykues çmoi se kjo kërkesë nuk është në kushtet e mospranueshmërisë së saj, sipas përcaktimeve të nenit 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile dhe, për rrjedhojë, me vendim të ndërmjetëm, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për t'i dhënë mundësi Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe kërkuases, znj. Antoneta Sevdari, të dëgjohen dhe të mbajnë qëndrimin e tyre lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019. Kolegji, pasi e shqyrtoi kërkesën e znj. Antoneta Sevdari për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, në seancë gjyqësore publike me praninë e kërkuases dhe të Komisioneres Publike, znj. Irena Nino, e cila përfundimisht u shpreh se kërkesa objekt shqyrtimi është në kushtet e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe Kolegji duhet ta pranojë atë, si dhe pasi konstatoi se provohet ekzistenca e rastit të përcaktuar në nenin 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për të cilin mund të kërkohej rishikimi i një vendimi që ka marrë formë të prerë, me vendim të ndërmjetëm, me shumicë votash, bazuar në nenet 494, shkronja “ë”, dhe 498, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, vendosi: (i) Pranimin e kërkesës së kërkuases, znj. Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019; (ii) Prishjen e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, dhe rigjykimin e çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit nr. 17 (JR), datë 13.09.2018, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018; si dhe (iii) Vazhdimin e gjykimit të çështjes në themel në seancë gjyqësore publike në praninë e palëve.*
5. Në vlerësimin tim, trupi gjykues nuk duhej t'i kërkonte në seancë gjyqësore publike Komisioneres të shprehet dhe të mbajë qëndrim lidhur me pranimin ose jo të kërkesës për rishikim, pasi, në këtë rast, shqyrtimi i kërkesës është kompetencë vetëm e trupit gjykues të Kolegjit në dhomë këshillimi dhe, si gjyqtare në pakicë, e vlerësoj si kalim procedural të kësaj kompetence te Komisionerja Publike.
6. Përveç sa më sipër, vlerësoj të theksoj se Kolegji është vënë në lëvizje nga kërkuësja Antoneta Sevdari, me kërkesën e datës 11.04.2023, me objekt: “*Rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6, datë 28.02.2019*”. Në vendimin e shumicës vërehet se, në cilësinë e ankuesit

është Komisionerja Publike dhe objekt: “Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari”. Edhe në këtë rast, nuk jam dakord me shumicën referuar standardeve ligjore, strukturimi i vendimit të dakordësuar nga shumica nuk është në përputhje me kërkesën e paraqitur, me objektin e saj, mbi të cilën është vënë në lëvizje Kolegji.

B. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit

7. Në koherencë me qëndrimin e mbajtur nga ana ime në vendimmarrjet e mëparshme, për sa i përket shqyrtimit të kërkesave për rishikim të vendimeve të formës së prerë të Kolegjit, vlerësoj se juridiksioni kushtetues i Kolegjit është i përcaktuar nga vetë Kushtetuta dhe ligji i zbatueshëm për procesin e rivlerësimit kalimtar, përkatësisht dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
8. Si gjyqtare në pakicë, theksoj se juridiksioni i Kolegjit, si organi i vetëm gjyqësor që shqyrton çështjet mbi ankimet kundër vendimeve të Komisionit, është i përcaktuar shprehimisht nga neni F i Aneksit të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, ndër të tjera, Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj. Ligjvënësi në këtë rast nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues ndaj vendimeve të tij, ndaj kam vlerësuar se nuk mund të pranohet përfshirja në këtë juridiksion të shqyrtimit të kërkesave për rishikim.
9. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, referencat që jep ligji i rivlerësimit, përkatësisht, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, se: “Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”, të cilat plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe, i përkasin vetëm *objektit dhe parimeve të procesit të rivlerësimit*, dhe në asnjë rast këto dispozita nuk gjejnë zbatim në funksion të shqyrtimit të kërkesave për rishikim të vendimeve të Kolegjit.
10. Në kushtet kur Kushtetuta, Aneksi i saj dhe ligji nr. 84/2016, nuk rezultojnë të kenë asnjë parashikim ligjor të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të vendimeve të Kolegjit dhe nga interpretimi i këtyre dispozitave shihet qartë vullneti i ligjvënësit, sipas të cilit ky juridiksion nuk është në përputhje me juridiksionin e gjykatave të zakonshme të vendit, çmoj se rishikimi i vendimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, nuk mund të zbatohet në rastin konkret.
11. Për mua, si gjyqtare në pakicë, zbatimi i vendimit të GjEDNj-së bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur zbatimi i vendimit kërkon nxjerrjen e një ligji të posaçëm nga autoritetet

ligjbërëse të vendit tonë. Kështu që rishikimi i vendimeve të Kolegjit bëhet vetëm atëherë kur ka rregullim ligjor, që në këtë moment mungon.

12. Për sa arsyetuar më sipër, kam votuar kundër vendimit për pranimin e kërkesës që i përket kërkueses Antoneta Sevdari, për rishikimin e vendimit nr. 6 (JR), datë 28.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi